



579

**VENDIM**

**NR. 192, DATË 06.10.2017**

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR DHËNIEN E LICENCËS SË TRANSMETIMIT AUDIO", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 153, DATË 18.07.2016 TË AMA-S, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 5 dhe nenit 19, pikat 1/ë dhe 16 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e ndryshimeve në rregulloren "Për procedurat dhe kriteret për dhënie e licencës së transmetimit audio", miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, të ndryshuar, si më poshtë vijon:

"Pas nenit 41, shtohen nenet e mëposhtme:

**Neni 41/1**

**Dokumentacioni i aplikimit për rinovimin e licencës për ritransmetimin e programeve të huaja**

Subjektet që kërkojnë rinovimin e licencës për ritransmetimin e programeve të huaja radio me përsëritësa duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Emërtimi i subjektit, adresa dhe emri i administratorit ose përfaqësuesit të aplikantit;
2. Emri i programit të huaj radio që do të ritransmetohet nga aplikuesi;
3. Ekstrakti i Thjeshtë dhe Historik i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), i subjektit që do të ritransmetojë programin e huaj radio, nëse subjekti i pajisur me licencë është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (origjinal ose fotokopje të noterizuar, të lëshuar jo më vonë se një muaj nga data e paraqitjes së aplikimit për rinovim licence);
4. Projekti teknik, të dhënat teknike mbi pajisjet e instaluar;
5. Marrëveshje me operatorin e huaj radio për ritransmetimin e programeve të tij në territorin e Republikës së Shqipërisë;
6. Deklaratë që përmbajtjet e programit të huaj të ritransmetuar me përsëritës radio, do të respektojnë kërkesat e ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

**Neni 41/2**

**Afati i licencave për ritransmetimin e programeve të huaja**

1. Licenca për ritransmetimin e programeve të huaja, radio me përsëritësa rinovohet me afat 5 (pesë) vjeçar me të drejtë rinovimi.
2. Aplikimi për rinovimin e licencës për ritransmetimin e programeve të huaja, radio me përsëritësa, duhet të bëhet të paktën 90 ditë përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së licencës.
3. Aplikimet për rinovimin e licencave për ritransmetimin e programeve të huaja radio me përsëritësa, të bëra para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të shqyrtohen do të shqyrtohen në bazë të neneve 41/1 dhe 41/2 të kësaj rregulloreje.
4. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar:**

**Gentian**

**SALA** 

**Zëvendëskryetar:**

**Sami**

**NEZAJ (Në mungesë)**

**Anëtarë:**

**Agron**

**GJEKMARKAJ** 

**Gledis**

**GJIPALI** 

**Piro**

**MISHA** 

**Suela**

**MUSTA**

**Zylyftar**

**BREGU** 